URDHËR
Nr. 635, datë 5.11.2013

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 15.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor për Ministrinë e Punëve të Brendshme, Sekretarit të Përgjithshëm, z. Genci Gjonçaj.
2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga data 11 tetor deri në datën 31 dhjetor 2013.
3. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm dhe strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij urdhri.
4. Urdhri nr. 382, datë 31.12.2012 "Për delegim kompetencash", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Saimir Tahiri